



Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, kryetarja e trupit gjyqes Raima Elezi, me praktikanten Shqiprie Podrimja, në lëndën penale, kundër të akuzuarit M. B. B. pënga fshati Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale fajdeja nga neni 343 paragrafi 3 e lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas marrëveshjes për pranimin e fajësisë PP/1.nr.119/17 të datës 08.12.2017, lidhur me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda PP/1.nr.119/17 të datës 08.12.2017, gjatë seancës së dëgjimit mbi marrëveshjen për pranimin e fajësisë, në prezencën e Prokurorit të Shtetit M. B., të akuzuarit, mbrojtësit të tij, av.H. S., të dëmtuarve M. K. dhe K. Z., me datë 13.12.2017, publikisht mori dhe shpallti këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari:

M. B., nga i ati H. dhe eëma A., e lindur Sh. i lindur më 15.02.1965 në fshatin Komuna e Suharekës, ku dhe tanë jeton, ka të kryer shkollën e mesme-gjimnazin, i martuar baba i dy fëmijëve, i pa punë-bujkë, i gjendjes së varfér ekonomike, deri më tanë i padënuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal 1002519557, në paraburgime prej datës 10.10.2017 deri më datë 13.12.2017.

### ËSHTË FAJTOR

Se për vete ka kontraktuar shuma dukshëm jo proporcionale të pasurisë në këmbime të shërbimeve për personat tjera, duke shfrytëzuar gjendjen e rëndë të banimit për njërin person dhe pa përvojën dhe gjendjen e rëndë financiare të personit tjeter, ku ka realizuar dobi pasurore për vete përkatesisht ku ka rezultuar me humbje financiare për personat e tillë në shumë prej më tepër se 25.000(njëzetepesëmijë) euro, në atë mënyre që në vitin 2009. Në fshatin K. të dëmtuarit K. Z. ia ka dhënë 5.000(pesëmijë) euro dhe për katër vite në vazhdimësi saktësishët deri në vitin 2013 e ka obliguar që t'ia kthej borxhin kryesor prej 5.000 euro së bashku me kamaten prej 2.440(dymjëekatërqintekatërdhjetë) euro, ndërsa të dëmtuarit M. K. në Suharekë, në muajin qershorë të vitit 2013 e deri në fund të muajit tetor të vitit 2016, ia ka dhënë borxh shumën prej 35.00(tridhjetepesëmijë) euro dhe e ka detyruar, që për çdo fillim dhe në mesë të muajit të ardhshëm që tia paguaj nga 1.500(njëmijëepesëqindë) euro, që i bie çdo muaj 3.000(tremijë) euro, ku sipas përllogaritjeve gjatë kësaj periudhe kohore i dëmtuari ia ka paguar gjithsej 110.000(njëqindëdhjetëmijë) euro, pra 75.000(shtatëdhjetepesëmijë) euro, më tepër në krahasim me bazën e borxhit.

-me këtë ka kryer veprën penale fajdeja nga neni 343 paragrafi 3 e lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 7,8,9,10,11,12,13,14,15,16,17,18,19,20,21,22,23,24,25,26,27,28,29,30,31,32,33,34,35,36,37,38,39,40,41,42,43,44,45,46,47,48,49,50,51,52,53,54,55,56,57,58,59,60,61,62,63,64,65,66,67,68,69,70,71,72,73,74 të KP, nenit 233 par. 1 të KPP dhe neneve të përmendor më lartë, e gjykon.



-me dënim me gjobë në shumën prej 1200(njëmijedyqindë) euro, të cilin dënim është i obliguar të paguaj në 3(tre) kiste mujore duke filluar prej datës 01 deri 05 të secilit muaj, 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe me,

-dënim me burg me kohëzgjatje prej 2(dy) vite e 8(tetë) muaj, në të cilin dënim llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 10.10.2017 deri më datës 13.12.2017.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mundë të paguaj dënimin me gjobë gjykata të njëjtin mund të zëvendësoj me dënim me burg, ashtu që për çdo 20 euro të dënimit me gjobë do të caktojë një ditë burg, çka do të thotë 60 ditë burg.

Prej të akuzuarit konfiskohen kartë monedhat në apoena prej 50 €, me numra serik: X 20078547131, Z31570960905, X75747449252, WA6555566593, WA4843413334, EB 1436415633, EB5508244845, EB2137595499, EB1954841139, WA5405292991, WA6341674087, UB5181362714, EA1662763861, si mjet i kryerjes së veprës penale.

Ndaj të pandehurit ndërpritet paraburgimi me ditën e sodit 13.12.2017.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 100€, në afate prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

#### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krimë të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP/I.nr.119/17 e datës 08.12.2017, kundër të akuzuarit M. [REDAKTUE] B. [REDAKTUE] nga fshati [REDAKTUE] Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale fajdeja nga nen 343 paragrafi 3 e lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së. Po ashtu së bashku me aktakuzën Prokurori i shtetit ka paraqitur edhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë PP.nr.119/17 e datës 08.12.2017, në bazë të së cilës me datë 13.12.2017 është mbajtur seanca dëgjimore, gjatë së cilës është shqyrta marrëveshja për pranimin e fajësisë, janë dëgjuar i akuzuari, mbrojtësi i tij, pala e dëmtuar, si dhe Prokurori i Shtetit.

Gjendjen faktike gjykata e ka vërtetuar ashtu siç është përcaktuar në dispozitivin e aktakuzës nën kushtet dhe rrethanat ligjore të marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit gjatë seancës dëgjimore ka propozuar që të aprovohet marrëveshja për pranimin e fajësisë PP.nr.119/17 e datës 08.12.2017, e cila është lidhur në bazë të nenit 233 par.1 të KPP, me vullnet të akuzuarit i cili ka qenë i vetëdijshëm dhe është pajtuar me kushtet e marrëveshjes, pas konsultimeve me mbrojtësin e tije dhe pas bindjes time se kjo marrëveshje është lidhur ne përputhje me ligjin dhe se i akuzuari nuk ka pasur kurrrfarë presioni me pëlqimin e tije është hartuar kjo marrëveshje dhe me këtë marrëveshje e kamë rekomanduar lartësinë e dënimit ashtu siç e parashohin dispozitat e nenit 343 paragrafi 3 e lidhur me paragrafin 1 të KP-së, pra në bazë të kësaj dispozite është paraparë dënim i kumulativ me dënim me gjobë dhe me burgim. Gjithashtu gjykatës i ka propozuar ashtu si në aktakuzë që të akuzuarit t'ia shqiptojë edhe dënimin plotësues, konfiskimin e 13 kartëmonedhave të sekuestruara në apoena nga 50(pesëdhjetë) euro, si mjetë që kanë rezultuar për kryerjen e veprës penale.

Palët e dëmtuara M. [REDAKTUE] K. [REDAKTUE] dhe K. [REDAKTUE] Z. [REDAKTUE] kanë deklaruar se nuk parashtronë kërkesë pasurore juridike dhe nuk kanë pasur dëshirë të angazhojnë mbrojtës.



Mbrojtësi i të akuzuarit av. H. [REDACTED] S. [REDACTED] deklaron se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të lidhur në mesë të palëve, pandehurit M. [REDACTED] B. [REDACTED] dhe Prokurorisë Themelore – Prokurori i shtetit Departamenti për Krimë të rëndë të datës 03.11.2017, konsideroj se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 233 i KPP-së nga se i pandehuri në prezençën time dhe me vullnet të plotë pa kurrfarë presioni e ka nënshkruar marrëveshjen të cilën e keni pranuar. Theksoj se kjo marrëveshja është lidhur para se të ngritë aktakuza dhe në këtë drejtim është plotësuar kushti ligjor që të pandehurit ti propozohet 20% më pak i dënimit kërcënues. Poashtu janë propozuar edhe dënimit kumulativ.

Konsideroj se minimum i dënimit të konfirmuar në marrëveshjen e propozuar sikurse ai me burg në kohë zgjatje prej 30 muajve, si dhe dëni mi me gjobë janë dënimet adekuate me të cilin do të arrihej shqiptimi i dënimit ndaj të pandehurit, që në të ardhmen të mos kryes ndonjë vepër penale. Prandaj ju propozoj që me rastin e shqiptimit të dënimit të keni parasysh rrëthanat lehtësuese për dënimin minimal nga se i njëjti për herë të parë konfrontohet me normat ligjore, është i papunësuar, i gjendjes së varfër ekonomike dhe babai i dy fëmijëve, dhe se të dëmtuarit nuk kërkojnë ndjekje penale e as parashtrojnë kërkësë pronësoro juridike. Poashtu pajtohet edhe me dënimin plotësues për konfiskimin e kartë monedhave.

I akuzuari M. [REDACTED] B. [REDACTED] pajtohet në tërësi me theksimet e mbrojtësit të tij.


Gjendjen faktike gjykata e ka vërtetuar ashtu siç është përcaktuar në dispozitivin e aktakuzës nën kushtet dhe rrëthanat ligjore të marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe provave në të cilat mbështetet aktakuza të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Kryetarja e trupit gjykues pas analizimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë si dhe analizimit të qëndrimeve të palëve, ka pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë PP.nr. [REDACTED] 17 e datës 08.12.2017, të lidhur ndërmjet Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për krimë të Rënda dhe të akuzuarit M. [REDACTED] B. [REDACTED] ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale fajdeja nga neni 343 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së duke ia shqiptuar gjykimin me burgim dhe me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka pranuar në tërësi marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë PP/I.nr.119/17 të datës 08.12.2017, të lidhur ndërmjet Prokurorit të Shtetit, Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për Krimë të Rënda dhe të akuzuarit M. [REDACTED] B. [REDACTED] nga fshati L. [REDACTED] Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale fajdeja nga neni 343 paragrafi 3 e lidhur me paragrafin 1 të KP-së.

Gjykata ka pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe ka konstatuar se i akuzuarit është fajtor për veprat penale për të cilat akuzohet.

Gjykata gjatë vendosjes lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimive pati parasysh të gjitha rrëthanat rënduese dhe lehtësuese të paraparë me nenin 73 dhe 74 të KP-së ku si rrëthanë rënduese mori parasysh shkallën e përgjegjëses penale dhe shkallën e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, ndërsa si rrëthana lehtësuese rrëthanat familjare dhe personale se është i martuar ka dy fëmijë, pranimi i fajësisë, prandaj duke pasur parasysh të gjitha rrëthanat gjykata vlerësoi se lartësia e dënimit me burg dhe me gjobë e caktuar sipas marrëveshjes, si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është i mjaftueshmë dhë i drejtë, duke konsideruar se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.



Vendimi mbi konfiskimin është marrë në bazë të nenit 69 të KP-së.

Vendimi mbi paraburgim është marrë në bazë të nenin 367 paragrafi 1 nen paragrafi 1.2 të KPPK-së

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 450 të KPP.

Nga të lartë cekurat u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**

- Departamenti i Krimeve të Rënda
- P.nr.123/17 me datë 13.12.2017

Praktikantja  
Shqiprie Podrimja

Përkthyesi gjyqësor  
Asnije Berisha

Kryetarja e trupit gjykues  
Raima Elezi



**KËSHILLË JURIDIKE:** ky aktgjykim është i plotfuqishëm që nga dita e shpalljes së tij me datë 13.12.2017, pasi që palët kanë hequr dorë nga e drejta e ushtrimit të ankesës.